



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KËSHILLI I BASHKISË

Datë 25.08.2021

Prot.42 (dyzetëdy)

Protokoll nr. 42

I mbajtur sot më datë 25.08.2021, në mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq, në sallën e mbledhjeve të këshillit të bashkisë, ora 10:00, (online).

1. Hapja e mbledhjes (korumi, miratimi i rendit të ditës, vendimet e mbledhjes së kaluar);
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 21.07.2021;
3. P-V "Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin korrik 2021";
4. P-V "Për zhvendosjen e familjeve dhe strehimin e tyre në godinën e ish-laboratorit qëndror, ndarjen e apartamenteve dhe përcaktimin e qirasë mujore";
5. P-V "Për miratimin e rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira pranë ish-Kombinatit të Sheqerit Maliq";
6. P-V "Për dhënie ndihme financiare për familjen e z.Hysen Strora dhe z.Romi Vasili, banesa e të cilëve u dogj pjesërisht si shkak i rënies së zjarrit";
7. P-V "Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.99, datë 24.12.2020 "Miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të administratës së bashkisë dhe strukturave të saj për vitin 2021";
8. P-V "Për miratimin e limitit të karburantit mujor të furnizimit me karburant për mjetet me targë AA 797 IR dhe mjetit AA 797 ML";
9. P-V "Për rishikimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2021";
10. P-V "Për akordim fondi si mbështetje financiare mbi botimin e librit "Katundet e Zbogjërës" shkruar nga z.Admir Belishta dhe "Tharja e Kënetës së Maliqit" shkruar nga z.Artan R. Hoxha;
11. Diskutime të tjera.

Këshilltarë të pranishëm në sallë:

Ornildi Demollari; Pranvera Begolli; Floreta Zaçe; Klement Zere; Tefik Meçollari; Dorjan Zholanji; Jonilda Koçllari; Fevri Sherifi; Rexhina Hëna; Aramndo Duttllari; Erinda Hamzaj; Ilia Xhuti; 12 (dymbëdhjetë) këshilltarë.

Këshilltarë online në platformën ZOOM:

Kristina Malelli; Fatjon Brahimllari; Ildir Limllari; Enida Avdolli; Vasilka Trajko; Valenitna Pashollari; Aldi Mullalli; Evisa Demollari (tetë) këshilltarë.

Të pranishëm nga Administrata:

Kryetari i Bashkisë z.Gëzim Topçiu; Drejtori i Shërbimit Social dhe Strehimit z.Azem Nuhu; P/Sektorit të Strehimit z.Ledion Mullalli.

Ornildi Demollari: Të nderuar kolegë, ju që jeni në sallë dhe ju që dhe ju që po na ndiqni online fillojmë me mbledhjen e radhës së këshillit të bashkisë. Me materialet jeni njohur të gjithë më parë. Miratojmë rendin e ditë si fillim? Kush është dakord me rendin e ditës? Kush



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

është dakord? Kundra? Abstenim? Miratohet me 12 vota me karton nga Këshilltarët në sallë dhe 8 vota nga Këshilltarët online, Miratohet rendi i ditës me 20 vota pro.

Kalojmë tek materialet e mbledhjes së kaluar të Këshillit, të cilat kanë marë dhe dakortësinë e Prefektit të Qarkut, janë dy vednime.

1. Vendim nr.54 datë 21.07.2021“Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% te fondit për muajin qershor 2021”;
2. Vendim nr.55 datë 21.07.2021 “Për miratimin e tavaneve përfundimitare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2022-2024 në nivel programi”;

Ornildi Demollari: Miratojmë protokollin e mbledhjes së kaluar, kush është dakord?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim? Miratohet me 12 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 8 vota nga këshilltarët online.

Miratohet rendi i ditës me 20 vota pro. Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në masën 6% të fondit për muajin korrik 2021”, kush e do fjalën? Ka ndonjë pyetje?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 12 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 8 vota nga këshilltarët online, miratohet me 20 vota pro.

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për zhvendosjen e familjeve dhe strehimin e tyre në godinën e ish-laboratorit qëndror, ndarjen e apartamenteve dhe përcaktimin e qirasë mujore”, kush e do fjalën?

Pranvera Begolli: Përshëndetje kryetar! E kam lexuar gjithë materialin, jam dakord për zhvendosjen e familjeve duke ditur kushtet që jetojnë, por do doja të dija vetëm diçka, t’i bëja një pyetje Kryetarit, këto familje do zhvendosen përkohësisht atje? Apo do kenë mundësi ta privatizojnë këtë banesë që po marin me qira?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Si duket nuk e paske lexuar si duhet materialin! P-V ta citon që këto familje shkojnë atje pa të drejtë privatizimi. Do kërkoja drejtorisë që P-V të ketë dhe një pikë që çdo familje të pajiset me një autorizim për transferim, ku të thuhet që kalimi në këtë godinë sipas vendimit të këshillit me nr... dhe konfirmuar nga Prefekti, pa të drejtë privatizimi e shkruar në autorizim. Zona atje është një zonë industriale, duke qenë kështu ne po i fusim për rast emergjent dhe ndoshta në një moment tjetër do shohim mundësinë për godina të tjera që mund të jenë për efekt të privatizimit ose familje të mund të kërkojnë të shkojnë te objekti 6-katësh që ne po ndërtojmë, kjo është e lirë dhe kjo banesë lirohet për raste të tjera deri sa ne t’i japim një zgjidhje deftintive. Më kuptove?

Pranvera Begolli: Të kuptova, po kisha vetëm një problem në vitin 2000-2003 këshilli i Bashkisë ka marë një vendim për disa familje që ishin te bashkia dhe u sistemuan te Kombinati i Sheqerit, tani na lindin probleme për t’i larguar ato na duhet përsëri një vendim këshilli për t’i larguar. Se me lajmërime dhe njoftime nuk i gjejmë dot adresën. Duhet cituar në vendim që nuk kanë të drejtë privatizimi dhe duhet të largohen në momentin që objekti përshatet për zonë industriale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Edhe familjet që ja u ka dhënë Këshilli kohë më parë nuk është dhënë që duhet t'i privatizojnë. Ka një vendim këshilli që asaj zonë i është dhënë me qira investitorëve privat për efekt të zhvillimit të biznesit. Kështu me këtë vendim e kemi të drejtën si Administratore Shoqërore e Kombinatit të Sheqerit t'i njoftojmë të lirojnë ambientet. Atë çfarë ne po bëjmë që dhe katin e parë të asaj godine të cilën ne nuk e kemi dhënë me qira ta bëjmë funksionale në këtë vit apo fillimi i vitit që vjen. Që të kemi disa ambiente me efekte shërbimi social për familje që vërtet mund të nglen jashtë se ka raste për një arsye një familje apo një individ mbeten në rrugë. Por për çdo rast do jenë ambiente provizore pa të drejtë privatizimi. Nuk mund të japim pronë në zonë industriale edhe sipas Planit të Përgjithshëm Vendor që është miratuar nga Këshilli edhe nga KKRTSH që mund të bëhen shtëpi. Dhe kjo në vendimin e këshillit që do meret sot të citohen e të jenë të shkruara. Mëqë mora fjalën tabela është bërë shumë gjerë, ajo çfarë kërkoja të dija është cila është vlera e qirasë që familjet do paguajnë, është kolona e fundit?

P/Sektorit të Strehimit Ledion Mullalli: Po, është kolona e fundit.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Me familjarët është diskutar? Është rënë dakord? Kështu i bie që vetëm tre familje paguajnë qira?

P/Sektorit të Strehimit Ledion Mullalli: Të tjerët nuk kanë të ardhura.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Pse nuk kanë të ardhura të tjerët?

P/Sektorit të Strehimit Ledion Mullalli: Sepse janë pa punë.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Janë në skemën e ndihmës ekonomike?

P/Sektorit të Strehimit Ledion Mullalli: Janë në ndihmë ekonomike, por kjo nuk llogaritet si e ardhur.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Nuk e di si e parashikon ligji, por minimalisht të gjitha familjet duhet të kenë qira. Sa do jetë qiraja minimale, 200 lekë? Nuk e di si e definon VKM-ja por një tarifë për mirëmbajtje duhet të ketë.

Pranvera Begolli: Aktualisht ai është objekt i Kombinatit të Sheqerit dhe një objekt detyrimisht jepet me qira, nuk mund të lëshohet i lirë. Nuk e di si janë procedurat, kam folur dhe me Ledionin por aktualisht ai është objekt i Kombinatit të Sheqerit, ashtu si ne lëshojmë objektet e tjera me qira.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Pranvera ai është objekt i Bashkisë Maliq, Bashkia Maliq është aksionere me të gjitha të drejtat e plota për Kombinatin e Sheqerit sipas vendimit të Qeverisë. Ti dëshiron ta quash pronë e Kombinatit, por nuk është kështu ka një vendim qeverie, po të kesh dëshirë ta lexoj, por ti duhet ta dish që thotë se ka autoritet të plotë që e përdor dhe për strehim përfaqësuesi i pronarit shtet. Nuk jam në këtë linjë, por një familje që është pa të ardhura, por pa të ardhura nuk mund të quhet se e merr një të ardhur. Nqs VKM-ja e parashikon që ato familje që janë në ndihmë ekonomike nuk paguajnë asnjë lekë, duhet ta lemë siç është, se është vendim qeverie, nuk e ndryshojmë dot, por po të jetë ndryshe pastaj.

P/Sektorit të Strehimit Ledion Mullalli: Nëse kanë të ardhura të ulta paguajnë 15% të të ardhurave në bazë të tabelës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Ledion me ndaj diçka, nëse një familje është në ndihmë ekonomike sipas VKM-së nuk paguan asnjë lekë?

P/Sektorit të Strehimit Ledion Mullalli: Po, nuk paguan.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Në rregull, edhe tjetra kemi një ose dy familje të cilat në godinën ekzistuese janë pronar, ato kanë pranuar të lëvizin?

P/Sektorit të Strehimit Ledion Mullalli: Për këto familje është një procedurë tjetër.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Ato familje do lëvizin në drejtim të banesave sociale?

P/Sektorit të Strehimit Ledion Mullalli: Ato familje nuk jetojnë këtu.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Emrat e atyre familjeve nuk janë në listë për të shkuar te banesat sociale?

P/Sektorit të Strehimit Ledion Mullalli: Jo, nuk janë.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Në rregull të kuptova, Kryetar unë në parim jam ta kalojmë P-V, pastaj këshilltarët mund të diskutojnë, por mëqë mora fjalën edhe urgjentisht të bëhet lëvizja si është parshikuar në P-V, me ato modalitetet pa të drejtë privatizimi edhe pastaj të shohim mundësinë që kati i parë i godinës të rehabilitohet, ta futim në investimet tona që mos e lemë në atë situatë që është.

Ornildi Demollari: Faleminderit z.Kryetar, ka ndonjë pyetje tjetër për këtë pikë? Ka ndonjë paqartësi tjetër?

E kalojmë në votim?

Kolegët që po na ndjekin online?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 12 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 8 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 20 vota pro, faleminderit.

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e rregullores për administrimin dhe mirëmbajtjen e banesave sociale me qira pranë ish-Kombinatit të Sheqerit Maliq”, kush e do fjalën?

Pranvera Begolli: Deri sa rregullorja është e mbështetur në VKM dha ka bazë ligjore, nuk kemi arsye pse të diskutojmë, unë them të kalojmë në votim.

Ornildi Demollari: Z.Kryetar ke diçka, do të shtosh ndonjë gjë te rregullorja?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Vet Drejtoria e Shërbimit Social duhet ta këtë objektin në mbikëqyrje dhe zbatimin e kontratës, nëqoftëse shkelen kriteret familja të largohet që atje.

Ornildi Demollari: E kalojmë në votim? Kolegët që po na ndjekin online, kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 12 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 8 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 20 vota pro, faleminderit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, “Për dhënie ndihme financiare, për familjen e z.Hysen Strora dhe z.Romi Vasili banesa e të cilëve u dogj pjesërisht si shkak i rënies së zjarrit”, e do dikush fjalën?

Pranvera Begolli: Detyrimisht deri sa janë dëmtuar nga zjarri, ka një proceverbabal, ta kalojmë P-V.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Janë dy raste të dëmtuara nga zjarri, ne si bashki nuk paguajmë asnjë lekë nga të ardhurat tona, janë fonde të parashikuara për Emergjencat Civile dhe në çdo rast ndiqet baza ligjore për efekt të përlogaritjes, kështu që nuk besoj se ka ndonjë problem.

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Valenitna Pashollari: Me lejë kryetar?

Ornildi Demollari: Po, Vali.

Valenitna Pashollari: Më vjen shumë mirë që bashkia mbulon 50% të dëmit, se ka pasur raste ka shkuar deri 20% vitin e kaluar. Kisha edhe diçka tjetër që për këto familje të merret një vendim, që të lirohen nga taksat e bashkisë nëse do bëjnë ndëstësën në atë sipërfaqe që ka patur. Se mund të ketë dhe raste abuzive me këtë nga familjarët duke shkaktuar vetë zjarrin dhe bërë objekt të ri. E kam kërkuar këtë edhe më parë, po nuk na është praqitur ndonjë P-V në këshill.

Ornildi Demollari: P-V për këto që sugjerove, për t’u përjashtuar nga taksat?

Valenitna Pashollari: Po.

Idlir Limllari: Me lejë?

Ornildi Demollari: Idlir urdhëro!

Idlir Limllari: E parshikon ligji që merremetimet e banesave në këto raste bëhen pa lejë dhe pa taksa, kështu që nuk ka nevojë për vendim këshilli, sepse nëse ka dëmtime të mureve dhe çatisë, ai mund t’i merremetojë ato, sepse ka një nen në rregulloren e urbanistikës që i lejon të bëjnë veprime, kështu ne nuk pse bëjmë vendim se na hapet precedent pastaj.

Ornildi Demollari: Idlir e kuptuam, faleminderit, Kryetar?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Ligji përcakton shumë drejt kur paguhen taksat kur përjashtohen, nëse flitet për lejë ndërtimi atje edhe ne kemi vendimarrjet tona nga 1-3% edhe ne kemi bërë minimumin e mundshëm sa parashikon ligji për lejë ndërtimi. Nëse flitet për riparime të ndryshme siç mund të jenë riparime çatie apo avllish muresh etj, ne kemi bërë me autorizime përkatëse dhe tarifën, janë miratuar në paketën fiskale të çdo viti, nëse ka propozime për këto raste atëherë duhet të fillojmë të shohim nënkategori, por tarifat për të cilat flasim janë 3000 lekë ose 5000 lekë të cilat janë minimale. Për rastet e zjarrit e shohim se dhe rastet nuk është se janë kaq të shumta. Për ta vazhduar ne vërtet kemi dhënë 20 apo 30% të dëmit në vitet e mëparshme, por nga ky vit që vetë qeveria apo Drejtoria e Emergjencave Civile është hera e parë që na akordon fond për këtë qëllim dhe ne e përdorim vetëm për destinacion për të tilla raste.

Ornildi Demollari: E qartë Vali?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Valenitna Pashollari: Jam dakord me atë që tha Idliri, por unë kam dy raste në Sovajn që ju janë ju janë djegur dhe brezat, që janë prej druri, si mund të riparohen këto?! Kur janë djegur plotësisht propozoj unë.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Rasti nuk i ngjan rastit, kur flasim për lejë ndertimi taifa në infrastrukturë është 1-3%, ne si bashki, ju si këshill e kemi miratuar 1% minimumin e mundshëm për banesa për efekt stehimi. Nuk kemi çfarë i ndryshojmë, se nuk ka raste përjashtimore si në rast zjarri. Për efekt të paketës fiskale që ne kemi marrë dia vendime që kanë të bëjnë me riparime me ndërim tjegullash etj, kemi vendosur një tarifë 3000 lekë dhe 5000 lekë në paketën fiskale. Kur bëhet me deklartë paraprake është diçka tjetër, zyra e Urbanistikës i ka të përcaktuara se janë me vendim parlamenti dhe ne nuk ndëryjmë dot. Ndoshta kur të miratojmë paketën fiskale për rastet e zjarrit të përjashtohet nga autorizimi, t'i jepet pa pagesë, por duhet marrë një nismë ose nga këshilli ose nga ne që t'ja çojmë zyrës Juridike ose Urbansitikës, n.q.s është bazuar ligjërisht ta miratojmë, se nuk ka ndonjë efekt as për bashkinë, as për familjen.

Ornildi Demollari: E qartë? Ka ndonjë pyetje tjetër për këtë pikë?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 12 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 8 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 20 vota pro, faleminderit.

Kalojnë të dy emrat si Hysen Strora dhe Romi Vasili. Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr.99, datë 24.12.2020 “Miratimin e numrit të punonjësve, nivelin e pagave të Administratës së Bashkisë dhe strukturave të saj, për vitin 2021”;

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Për informacion bëhet fjalë për një shtesë dhe një rregullim të një page nga 6 orë në 8 orë punë. Bëhet një shtesë për shkak të rritjes së performancës së gjithë drejtorive të bashkisë, kam vendosur që mos ketë më mjete të përcaktuara për një drejtori por mjetet të jenë në dispozicion të të gjithë administratës dhe sipas ngarkesës ose një grafiku të caktuar të gjitha mjetet, si Polica Bashkiake, Drejtoria e Pyjeve apo Inspektoriati ta kenë të përcaktuar me një grafik dhe kjo na kërkonte të shtonim dhe një shofer për efekt të mbulimit jo vetëm 8 orë por edhe 24 orë në momente të caktuara. Po flasim për drejtori që janë shumë të domosdoshme si Shërbimi Pyjor, Emergjencia Civile në raste zjarre apo përmbajtës. Ne e pamë të arsyeshme ta bënim këtë shtesë, kjo dhe me një P-V tjetër për efekt të limitit të karburantit që nuk shtojmë.

Pranvera Begolli: E kemi pikë më vete në rend dite, aktualisht ne kemi miratuar pozicionet e administratës, këto fonde nga do dalin për këtë shtesë? Nga do pakësojmë këtë shtesë për pozicioni e shoferit?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Po, nuk do shtohet asnjë fond, të gjithë shpenzimet mbulohen nga fondet që janë miratuar në vendimarrjen e fillimvitit për miratimin e buxhetit për vitin 2021. Pasi ne në çdo rast kemi pozicione bosh për efekt të mosplotësimit të pozicioneve ka raste që kërkohet një inxhinier nuk e gjen, paga edhe pse është llogaritur për 12- muaj nuk është marrë, kërkon një jurist i cili është larguar, vendi është bosh. Ka fonde dhe nga kalkulimet që Drejtoria e Financës ka bërë, jo vetëm në administratë por në të gjitha strukturat punohet me një rezervë. Pasi në çdo rast edhe të vendimarrjeve që merr qeveria apo të tjera, në rregullat financiare punohet me një fond rezervë në fondin e pagave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Ornildi Demollari: Dakord, ke diçka tjetër?

Pranvera Begolli: Kryetari kapi dhe P-V tjetër miratojmë 7 pastaj 8.

Ornildi Demollari: Ka ndonjë pyetje tjetër për këtë pikë?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 12 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 8 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 20 vota pro, faleminderit.

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për miratimin e limitit të karburantit mujor të furnizimit me karburant për mjetet me targë AA 797 IR dhe mjetit AA 797 ML”;

Pranvera Begolli: Kryetar e shpjeguat pak shkurt por, aktualisht kemi miratuar limit karburanti për mjetin AA797IR, një limit të caktuar, do doja të shpjegojem me hollësi pjesë e karburantit që ishte për IR kalon te ML apo shtojmë limit tjetër karburanti?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: 400l po i kalonë mjetit me targë AA797ML dhe 100l i mbeten mjetit me targë AA797IR për të cilin shtuam dhe një pozicion shofer. Se po hymë në elemente teknike, nëse deri më parë kemi patur një mjet për administratën lëvizje të brendshme, ky mjet i kalon shërbimeve të tjera si: Polica Bashkiake, Drjeoria e Pyjeve apo Inspektoriatit etj. dhe ky përdoret për administratën për lëvizjen e vlera monetare, financiare Korçë-Maliq, etj.

Ornildi Demollari: Tjetër?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 12 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 8 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 20 vota pro, faleminderit.

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për rishikimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2021”, është fjala për një transferim fondi, besoj se e keni parë? Ka ndonjë pyetje? Një shpjegim të lutem Kreytar?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Kemi një rast emergjent të dëmtimit të mjetit traktor me zinxhira pasi motori pati probleme, atëherë ekspertët motoristë, mekanikë e hapën, panë gjendjen e tij edhe kjo vlerë është e domosdoshme, nuk mund ta bënim dot pa lëvizje të fondit brenda buxhetit për efekt të riparimit të mjetit traktor me zinxhira, që është shumë i domosdoshëm jo vetëm në këtë periudhë për rrugët e fushave por edhe në periudhën e dimrit dhe e pamë të arsyeshme që të nxitonim për ta riparuar që mos kemi një mjet jashtë funksionit.

Pranvera Begolli: Nuk ka problem që këto fonde ikin nga mirëmbajtje Loti-I dhe kalojnë këtu?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Janë fonde që kanë tepruar nga Prokurimet.

Ornildi Demollari: Dakord, ke diçka tjetër?

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 12 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 8 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 20 vota pro, faleminderit.

Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës, P-V “Për akordim fondi si mbështetje financiare mbi botimin e librit “Katundet e Zbogjërisë” shkruar nga z.Admir Belishta dhe botimin monografik “Tharja e Kënetës së Maliqit” shkruar nga z.Artan R. Hoxha”, janë dy çështje që ne jemi njohur, kërkesa drejtuar Këshillit ka kohë që është bërë.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Ka një problem ose lapsus në P-V midis fondit të akorduar për botimin, duhet të jetë e anasjellata, ju kërkoj ndjesë për gabimin.

Ornildi Demollari: Për botimin “Katundet e Zbogjërisë” shkruar nga z.Admir Belishta shuma të jetë 100.000 lekë dhe “Tharja e Kënetës së Maliqit” shkruar nga z.Artan R. Hoxha shuma të jetë 150.000 lekë.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Flasim për dy botime historike të cilat ne do marim kopje si bashki. Po mundohemi të bëjmë një bibliotekë, një fond arkivor i cili është shumë i nevojshëm, unë duke gjetur 100 tituj për t'i vendosur në një nga shkollat e qytetit. Prandaj nuk dua të hapim lojë me lloj-lloj botimesh, po flasim për libra historikë të cilët sjellin një histori të zonave të caktuara. Për këtë qëllim të ngrihet një komision vlerësim, që ta vlerësojë hyn në këtë kategori apo jo. Ndoshta mund të jetë i njëjti komision, ai i Titujve të Nderit.

Ornildi Demollari: Ka pyetje? Ka koment për librat? Të kë në nga një kopje shkollat Kryetar të librave?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Duhet parë a janë në listën e titujve të Ministisë së Arsimit se mos krjojmë probleme me historinë, se çdo libër kalon në një filtër nga historianë për një të dhënë historike.

Ornildi Demollari: Dakord!

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 12 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 8 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 20 vota pro, faleminderit.

Te diskutime të tjera kemi dy P-V, “Për miratimin e tarifës së hyrjes në eventet e organizuara tek “Pylli i Fazanëve”, besoj se e keni materialin? Po ju lexoj P-V.

1. Miratimin e tarifës 100 lekë për person për hyrje dhe pjesëmarrje në eventet e ndryshme të organizuara tek Pylli i Fazanëve.
2. Struktura e ngarkuar për mbledhjen dhe arkëtimin e kësaj tarife është Drejtoria e Shërbimit Pyjor në bashki dhe Sektori i Rekreacionit, Turizmit dhe Rinisë.
3. Ky Vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Korçë.

Pranvera Begolli: Jam dakord me propozimin, por do doja që në aktivitet që organizojnë shkollat nxënësit mos e paguajnë tarifën.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Kemi një P-V i cili është shtesë i paktës fiskale, paketa fiskale i ka të parashikuar kategoritë sa paguajnë 50 lekë, 20 lekë, pa lekë për fëmijët, nuk ka të bëjë me këtë, ka të bëjë me evente të cilat ne kemi filluar t'i organizojmë me kërkesa të ndryshme. Ka të bëjë me aktivitet të mëdha artistike, ku ata nxjerrin të ardhura. Dhe në momentin që nxjerrin të ardhura ne e pamë të arsyeshme të vendosim një tarifë. Bëhet fjalë për këto evente apo të tilla të ngjashme. Nxënësit e shkollave nuk e kanë 100 lekë por 20 lekë sipas VKB-së, fëmijët e kanë 0.

Pranvera Begolli: Për këtë të falenderojmë Kryetar dhe për gjithë atë investim që keni bërë atje, por kur do e ketë pronë bashkia Pyllin e Fazanëve?

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Po punojmë për këtë.

Ornildi Demollari: Dakord!

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 12 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 8 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 20 vota pro, faleminderit.

Kemi dhe një P-V tjetër, P-V "Për dhënien e titullit "Mirënjohja e Bashkisë (pas vdekjes)" Z. Marsel Nazifi. Nuk mendoja ta diskutoja këtë. Po Kryetar.

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Dy fjalë, nuk dua të merrem me diskutimin e titullit, dua të them dy fjalë për atë inxhinier, për atë njeri të veçantë që unë e kam shprehur kudo që nuk mund të gjes të dytë në kuptimin e profesionistit, njeriut, me të gjithë elementët pozitivë. Kështu që le të jetë kjo dhe një vlerësim për të, besoj se na dëgjon. Nga ana e bashkisë, këshillit patjetër dhe gjithë komuniteteve tona për vlerësim të emrit të mirë që ai la dhe kontributit. Ne kemi humbur një specialist, një nga më të mirët që unë ka patur në bashki, i pahuar qoftë!

Pranvera Begolli: Propozoj të mbajmë 1 minutë heshtje në nder të tij!

Ornildi Demollari: Atëherë 1 minutë heshtje ne nder të Mareselit, i pahuar dhe i përjetshëm kujtimi i tij! I propozojmë këshillit të bashkisë t'i jepet titulli "**Mirënjohja e Bashkisë (pas vdekjes)**" Z. Marsel Nazifi, me motivacionin: "Për kontributin e çmuar që ka dhënë si punonjës pranë Bashkisë Maliq, ku ka ndërruar dhe jetë gjatë kryerjes së detyrës.

E kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Kundra?

Abstenim?

Miratohet me 12 vota me karton nga këshilltarët në sallë dhe 8 vota nga këshilltarët online.

Miratohet me 20 vota pro, faleminderit.

Kemi dhe dy P-V të tjera, një për dhënie Titull Nderi "Mirënjohja e Bashkisë", z.Koçi Tahiri dhe e dyta dhënie Titull Nderi "Qytetar Nderi" për Kapedanët e Gorës, por do doja ta konsultoja këtë pjesë, kjo e kapedanve erdhi dhe më parë në këshill dhe nuk u miratua për shkak të konfirmimit nga institucioni përkatës për pastërtinë e figurës, dhe me sa di nuk ka ardhur konfirmimi!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Kryetari i Bashkisë Gëzim Topçiu: Ne kemi çuar shkresën përkatëse me gjithë formularët dhe listat dhe ka qenë problem vetëm një emër, dhe ky vetëm për problem të atësisë. Nëse e presim dhe atë e presim për të dy P-V nuk është problem i kalojmë herën tjetër.

Ornildi Demollari: I propozoj këshillit t'i kalojmë në mbledhjen tjetër.

Pranvera Begolli: Në rregull!

Mbledhja Mbyllet!

KRYETARI I KËSHILLIT

Ornildi DEMOLLARI
